

VENDIM
Nr. 215, datë 24.8.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SMART TRADE AND CONSULTING” SHPK, PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, si dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1476/1 prot., datë 19.8.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Smart Trade & Consulting” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 389, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1384/1 prot., datë 9.8.2022, ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence.

- Në zbatim të nenit 16, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, i licencuari duhet të paraqesë në ERE një aplikim për rinovim jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur në afat.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”;
- dokumentacioni juridik dhe administrativ – neni 9, pika 2, germat “c”, “d” dhe “e”;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germat “b” dhe “d”;
- dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, germa “c”.

- Shoqëria “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, duhet të depozitojë në ERE dokumentacion/informacion në lidhje me nenin 9, pika 2, germat “a” dhe “b”, nenin 9, pika 3, germat “a” dhe “c”, si dhe nenin 9, pika 4.8, germat “a” dhe “b”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti